



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës SPITALI RAJONAL Durrës

Nr. 1645 prot.
Durrës, më 24.08.2024

Nr. 1380 Prot.
Durrës, më 03.10.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU"
Durrës**

**DHE
SPITALIT RAJONAL Durrës**

Marrëveshja e mëposhtme lidhet ndërmjet Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, konkretisht Rektor i Universitetit Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi dhe Spitalit Rajonal Durrës përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i këtij Spitali Z. Ani Dyrmishi.

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo marrëveshje lidhet me qëllim bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve për ideimin dhe realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme me interes zhvillimin e përbashkët.

**Neni 2
Objekti i bashkëpunimit**

Universiteti "Aleksandër Moisiu" dhe Spitali Rajonal Durrës do të bashkëpunojnë për realizimin e këtyre aktiviteteve:

- Percaktimin e procedurës dhe dokumentacionit për kryerjen e praktikave dhe proceseve mësimore të studentëve të Universitetit "Aleksandër Moisiu" pranë Administratës dhe pavioneve të Spitalit Rajonal Durrës;
- Shkëmbimin e përvojës së dyanshme lidhur me menaxhimin institucional;
- Aktivitete dhe publikime të përbashkëta në kërkim shkencor;
- Pjesëmarrje në seminare, konferenca, evenimente dhe takime akademike;

- Ofrimi i ekspertizës në kurrikulën e lëndëve profesionale mjekësore duke ndikuar në përmirësimin e saj si dhe duke ofruar personelin e kualifikuar Infermieror dhe Mjekësor të Spitalit Rajonal Durrës për lektimin e lëndëve të karakterit mjekësor sipas specialiteteve përkatëse.

Neni 3 Komunikimi

Të dyja palët bien dakort për të shkëmbyer rregullisht informacion në lidhje me aktivitete projekte me interes të dy institucioneve. Për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve palët bien dakort nëpërmjet realizimit të takimeve koordinuese ndërmjet stafit akademik përgjegjës të praktikave dhe personelit të SRD, i caktuar në mundësimin e realizimit të këtyre praktikave.

Neni 4 Buxheti

Nese nga zbatimi i kesaj marrëveshje bashkëpunimi do te kete angazhime financiare, ato do te merren persiper nga UAMD.

Neni 5 Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të jetë në fuqi për një periudhë 2 (dy) vjeçare që nga data nënshkrimit nga të dyja palët, me mirëkuptimin që mund të përfundojë edhe përpara këtij afati me iniciativën e njëres prej palëve, duke njoftuar me shkrim 30 (tridhjetë) dite përpara. Gjithashtu kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të shtyhet në afat apo amendohet në pjesë veçanta të saj, nëse të dy palët bien dakord me shkrim.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik dhe pasi nënshkruhet nga Përfaqësuesi i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Përfaqësuesi i Spitalit Rajonal Durrës. Kjo marrëveshje përpilohet në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS SPITALI RAJONAL DURRËS

REKTOR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi



DREJTOR

Ani Dyrmishi

